



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E KONTROLLIT TË TERRITORIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TË
ZHVILLIMIT TË TERRITORIT DHE MENAXHIMIT TË KONTRATAVE

BASHKIA KORÇË
NR 8200 PROT
DATA 19/08/2025

Korçë, më ____ . ____ . 2025

RELACION

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË BASHKISË KORÇË NR. 185, DATË 28.12.2022,
“PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT TAKSI NË BASHKINË KORÇË”

Me vendim të Këshillit të Bashkisë Korçë nr. 185, datë 28.12.2022, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi në Bashkinë Korçë”, janë përcaktuar edhe vendqëndrimet për automjetet taksi me (4+1) vende. Në muajin gusht në qytetin e Korçës ka filluar aktivitetin në shërbimin taksi një subjekt “KO-TAXI” sh.p.k, i cili disponon tre autovetura me motor elektrik me vit prodhimi 2024 me (4+1) vende. Këto mjete janë targuar për herë të parë në qershor dhe korrik 2025, pra kanë dalë në qarkullim për herë të parë si automjete taksi. Këto janë autoveturat e para me motor elektrik të liçencuara prej Bashkisë Korçë. Ky subjekt ka paraqitur kërkesë për një vendqëndrim taksi të dedikuar vetëm për autoveturat elektrike të cilat disponon. Kërkesa është për 4 vende parkimi, me pretendimin se do të shtohen edhe dy autovetura të tjera. Vendet e kërkuara janë pranë hyrjes kryesore të Pazarit të vjetër të qytetit dhe janë në pozicion të përshtatshëm për marrjen e shërbimit taksi nga qytetarët dhe vizitorët në këtë pjesë të qytetit. Por këto vende parkimi janë miratuar si vendparkime me pagesë me vendim të Këshillit të Bashkisë Korçë nr. 111, datë 03.08.2019, “Mbi zonat e parkimit me pagesë në rrugë”, i ndryshuar. Meqënëse shërbimi taksi me automjete elektrike është një risi për Bashkinë Korçë dhe me qëllim për ta stimuluar, propozojmë që të miratohet kërkesa e këtij subjekti, por vetëm për tre vende parkimi, duke pasur parasysh që megjithë shtesat e mjeteve që mund të kryejë subjekti, disa prej tyre do të jenë në lëvizje. Pra destinacioni i këtyre tre vendeve të parkimit të ndysohet nga parkim me pagesë, në parkim për automjete taksi elektrike, kjo sipas plan-vendosjes bashkëlidhur. Sqarojmë se detyrimi për kryerjen e pagesës të tarifës vjetore të parkimit për këtë subjekt do të jetë i njëjtë si edhe për subjektet e tjera taksi. Pra sipas vendimit përkatës të përvitshëm të Këshillit të Bashkisë Korçë “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Korçës”, në përputhje me numrin e automjeteve të liçencuara me të cilat subjekti do të kryejë shërbimin taksi.

DREJTOR I DREJTORISË TË
PËRGJITHSHME JURIDIKE
Anxhela (Dishnica) Qeramixhi

DREJTOR I DREJTORISË TË
PËRGJITHSHME TË PLANIFIKIMIT
DHE KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT
TË TERRITORIT DHE MENAXHIMIT
TË KONTRATAVE
Ndriçim Hoxha

KRYETARI I BASHKISË
Sotiraq Filo

PËRGJEGJËS I SEKTORIT TË LIÇENCIMIT
NË DREJTORINË E KONTROLLIT
TË TERRITORIT
Lorenc Palodhi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

P/VENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ . 2025

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË BASHKISË KORÇË
NR. 185, DATË 28.12.2022, “ PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
SHËRBIMIT TAKSI NË BASHKINË KORÇË”**

Këshilli i Bashkisë Korçë pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë të Kontrollit të Territorit dhe Drejtorisë të Përgjithshme të Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave “Për një shtesë në vendimin e Këshillit të Bashkisë Korçë nr. 185, datë 28.12.2022, ‘Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi në Bashkinë Korçë’, bazuar në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, "Për transportet rrugore", i ndryshuar, neni 35; ligjin nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 54, pika k; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës të Shqipërisë”;

VENDOSI :

1. Në pikën 3 të vendimit të Këshillit të Bashkisë Korçë nr. 185, datë 28.12.2022, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi në Bashkinë Korçë”, shtohet nënpike:
XIII. Në rrugën “Kiço Greço”, pranë hyrjes kryesore të Pazarit të vjetër të qytetit, vetëm për automjete elektrike taksi (3 vende parkimi, sipas plan-vendosjes nr. 13).
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kontrollit të Territorit, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe Policia Bashkiake.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva Naçi

Ana Verushi

Miraturar me _____ vota

Vota Pro _____

Vota Kundër _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur më datë _____

P-V NR. 13

